



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 173

Tiranë – E hënë, 2 tetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 522, datë 27.9.2017	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Perusë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të veçanta ose të shërbimit.....	8831
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 523, datë 27.9.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	8833
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 27.9.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 36, datë 16.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar.....	8833
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 27.9.2017	Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit të investimeve për funksionin e ujitjes dhe të kullimit për bashkitë.....	8834
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 526, datë 27.9.2017	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Rezar Veseli.....	8835
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 27.9.2017	Për shpronësimin, marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit të përhershëm të kalimit, për interes publik, mbi disa pasuri të paluajtshme, pronë private, që preken nga korridori i punës (rrugët hyrëse) dhe sistemi i gazsjellësit (mikrotuneli), pjesë e projektit Trans Adriatik (TAP)	8835
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 528, datë 27.9.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 37, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 100/20 KV Gjiri i Lalëzit, Durrës”	8839

Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 20, datë 22.9.2017	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar	8839
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 13541, datë 29.9.2017	Mbi hyrjen në fuqi të disa marrëveshjeve ndërkombëtare.....	8841
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Aleksander Backa.....	8841



VENDIM

Nr. 522, datë 27.9.2017

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË PERUSË, PËR HEQJEN
E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E
PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË
VEÇANTA OSE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Perusë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të veçanta ose të shërbimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
PERUSË PËR HEQJEN E VIZAVE
PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE, TË VEÇANTA
OSE TË SHËRBIMIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Perusë, në vijim të referuara si “Palët”,

duke marrë parasysh bisedimet e zhvilluara nga autoritetet e vendeve të tyre që kanë për qëllim forcimin e lidhjeve tradicionale të miqësisë dhe bashkëpunimit që ekziston midis dy qeverive, dhe *me dëshirën* për rritjen e zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërmjet vendeve të tyre përkatëse, me qëllim lehtësimin e udhëtimit të shtetasve të tyre, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni I

Shtetasit e të dyja Palëve, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, të veçanta ose të shërbimit, mund të hyjnë në mënyrë të përsëritur në territorin e Palës tjetër dhe të qëndrojnë atje për një periudhë që nuk i kalon nëntëdhjetë (90) ditë brenda 180 ditëve, pa qenë e nevojshme për të marrë vizë.

Neni II

Në qoftë se mbajtësit e pasaportave të referuara në nenin I të kësaj Marrëveshjeje synojnë të vazhdojnë qëndrimin e tyre, pas përfundimit të afatit të lartpërmendur në secilin prej të dy vendeve, atyre do t’u kërkohet për të marrë autorizimin përkatës nga autoritetet vendore për të zgjatur qëndrimin e tyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni III

Mbajtësit e pasaportave të përmendura në këtë Marrëveshje, që janë të autorizuar nga autoritetet kompetente në çështjet e emigracionit, mund të hyjnë dhe largohen nga Shqipëria dhe Peruja në çdo moment, pa asnjë kufizim, me përjashtim të atyre të përcaktuara në dispozitat e sigurisë, emigracionit, doganës dhe ato shëndetësore, si dhe si të tjera që mund të jenë ligjërish të zbatueshme për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të veçanta ose të shërbimit.

Neni IV

Shtetasit e Palëve, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, të veçanta ose të shërbimit, duhet të përmbushin rregullat e hyrjes dhe qëndrimit, si dhe të legjislacionit aktual kombëtar në territorin e shtetit pritës gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre.

Neni V

Shtetasit e Palëve, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, të veçanta ose të shërbimit, të cilët janë caktuar si anëtarë të misionit diplomatik ose konsullor në territorin e Palës tjetër, nuk do të kërkojnë për të marrë vizën e duhur brenda tridhjetë (30) ditësh pas hyrjes në vend. Brenda kësaj periudhe, ata mund të marrin autorizimet e nevojshme të aplikueshme për stafin e misioneve të huaja që banojnë në vend, në përputhje me ligjet e Palës.



Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen gjithashtu ndaj familjes së ngushtë të personave të përmendur në këtë nen, me kusht që ata të janë mbajtës të pasaportave diplomatike, të veçanta ose të shërbimit.

Neni VI

Të dyja Palët rezervojnë të drejtën të refuzojnë pranimin e personave të shpallur *non grata* apo që mund të rrezikojnë paqen, rendin dhe shëndetin publik ose sigurinë kombëtare; dhe të shkurtojnë qëndrimin e atyre që ndodhen tashmë në territorin e shtetit pritës.

Neni VII

Palët mund të përfundojnë këtë Marrëveshjeje, tërësisht ose pjesërisht, për arsye të mbrojtjes së rendit, sigurisë ose shëndetit publik. Pëzullimi dhe rinovimi duhet t'i njoftohen me shkrim Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike, tridhjetë (30) ditë para hyrjes në fuqi të kësaj mase.

Pa cenuar dispozitat e paragrafit të mësipërm, pëzullimi nuk do të cenojë qëndrimin e shtetasve të një Pale që kanë hyrë në mënyrë të vlefshme në territorin e Palës tjetër.

Neni VIII

Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike modelet e pasaportave të vlefshme diplomatike, të veçanta dhe të shërbimit, gjatë tridhjetë (30) ditëve pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Në rast të ndonjë modifikimi të pasaportave të vlefshme diplomatike, të veçanta dhe të shërbimit, Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike modelet dhe informacionin e tyre në lidhje me aplikueshmërinë e pasaportave të vlefshme diplomatike, të veçanta dhe të shërbimit, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas qarkullimit të pasaportave të përmendura.

Neni IX

Në rastin e humbjes apo të dëmtimit të një pasaporte diplomatike, të veçantë ose të shërbimit, nga një shtetas i njëres nga Palët, ndërsa ndodhet në territorin e Palës tjetër, misioni diplomatik ose konsullor i asaj Pale mund të dërgojë dokumentet në mënyrë që të lejojë atë person të kthehet në vendin e tij. Në të njëjtën kohë, misioni diplomatik apo konsullor njofton Palën tjetër për incidentin nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni X

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve.

Neni XI

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar.

Neni XII

Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje mund të kryhet mbi bazën e miratimit me shkrim ndërmjet Palëve. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin XIV të kësaj Marrëveshjeje.

Neni XIII

Secila Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshjeje duke i dhënë një njoftim me shkrim Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pushimi i Marrëveshjes hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të gjashtë pas datës kur pala tjetër ka marrë një njoftim të tillë.

Neni XIV

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore që janë të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Hartuar në Nju-Jork, në ditën e 16-të të qershorit 2017, në dy kopje origjinale në gjuhët shqip, spanjisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze ka përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Besiana Kadare

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË PERUSË

**VENDIM**

Nr. 523, datë 27.9.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, çregjistrohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

(LISTA E OKB-SË)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”;

1. ZULKIFLI; ABDUL HIR

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 524, datë 27.9.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 36, DATË 16.1.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E
ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË
ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 752, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës dhe të kriterëve për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe të masës së shpërblimit të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “b”, e pikës 1, të vendimit nr. 36, datë 16.1.2013, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Znj. Jonida Gaba, përfaqësuese e ministrit të Drejtësisë;”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe bordi drejtues i saj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi



VENDIM
Nr. 525, datë 27.9.2017

**PËR SHPËRNDARJEN DHE DETAJIMIN
E FONDIT TË INVESTIMEVE PËR
FUNKSIONIN E UJITJES DHE TË
KULLIMIT PËR BASHKITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 16, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërndarjen dhe detajimin e fondit të investimeve për skemat ujitëse, me vlerë 380 000

000 (treqind e tetëdhjetë milionë) lekë, sipas bashkive, dhënë në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Tepricat eventuale të prokurimeve të fondit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi rishpërndahen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministri Brendshëm, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Tabela 1. Fondi për rehabilitimin e skemave ujitëse sipas bashkive.

Bashkia	Emërtimi i projektit	Vlera në lekë
	Total	380 000 000
Tiranë	Rehabilitimi i pjesshëm i skemave ujitëse dhe sifonave të Mustafa Kow, Rove (Ballçllik), Alltate	10 000 000
Vlorë	Skema ujitëse, rezervuar Kallafet, Sherishte, Kanine, Alikoke	10 000 000
Finiq	Skema ujitëse SRU-4, kanali ujitës K-K-2 “ALIKO”	10 438 443
Sarandë	Rikonstruksion i kanalit ujitës 17-S2 (Lugjeve)	16 975 200
Konispol	Skema ujitëse SR - U - 2, kanali V55	11 666 660
Delvinë	Rikonstruksion i pjesshëm i kanalit ujitës K-K-5 Bajkaj - vazhdim	8 960 000
Gjirokastër	Rehabilitimi i skemave ujitëse GJU 4, GJU4/4, GJU 5, kanali vaditës V3 -vazhdim	9 000 000
Tepelenë	Rehabilitimi i kanalit ujitës Gusmar	21 787 602
Këlcyrë	Rehabilitimi i skemës ujitëse të rezervuarëve - Këlcyrë dhe Varibop	19 206 600
Elbasan	Sifon i k. ujitës Letan-Gurabardh	12 000 000
Elbasan	Sifon i k. ujitës Vreshtan-Shushicë	8 000 000
Korçë	Rehabilitimi në kanalet ujitëse sekondare të rezervuarit Gjanç	40 000 000
Maliq	Portbarazhi kolektori i Sovjanit	5 800 000
Kolonjë	Kanali ujitës, Përroi Qinam (ERU-V30)	13 000 000
Pogradec	Rezervuari Frangovisht+Hykollaret	10 069 305
Ura Vajgurore	Rikonstruksioni Ura Vajgurore-Poshnjë dhe Bypass Ciflik	14 999 842
Dibër	Faza II e kanalit Sifoni Brezhdan-Vakuf	3 240 000
Dibër	Rikonstruksioni i kanalit Llixha-Brezhdan dhe Gurra-Venisht	13 575 966
Shijak	Rehabilitimi i skemës ujitëse Maminas	11 119 002
Has	Rehabilitimi i ushqyesit të rezervuarit Fajza	7 670 000
Tropojë	Rikonstruksioni i kanalit të Gashit, faza I	10 000 000
Fier	Rehabilitimi i kanalit ujitës, dega e Fierit (Skema e ujitjes FRU-1)	9 500 000
Fier	Rehabilitimi i kanalit ujitës, dega e Dermenasit (Skema e ujitjes FRU-1)	9 000 000
Roskovec	Rehabilitimi i pjesshëm i rrjetit në zonën Suk 1, Roskovec (vazhdim)	14 975 132
Lushnjë	Rehabilitimi i kanalit ujitës, fshati Plug	14 529 831
Kurbin	Ndërhyrje në kanalet sekondare të U12	16 497 828
Mirditë	Rehabilitim i kanalit ujitës, dalje tuneli Malaj-1 - Tene (Ujëmbledhësi Malaj-1 2.35 milionë m ³ ujë)	20 488 589
Fushë-Arrëz	Rikonstruksion i kanalit ujitës Ferrcoj - Lulaj, fshati Kryezi	12 500 000
Malësia e Madhe	Skema ujitëse me rehabilitimin e kanaleve sekondare të Shtodrit	15 000 000

**VENDIM**

Nr. 526, datë 27.9.2017

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. REZAR VESELI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Rezar Veseli, në masën 1 311 000 (një milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 527, datë 27.9.2017

PËR SHPRONËSIMIN, MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM DHE VENDOSJEN E SERVITUTIT TË PËRHERSHËM TË KALIMIT, PËR INTERES PUBLIK, MBI DISA PASURI TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA KORRIDORI I PUNËS (RRUGËT HYRËSE) DHE SISTEMI I GAZSJELLËSIT (MIKROTUNELI), PJESE E PROJEKTIT TRANS ADRIATIK (TAP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 7 e 8, të pjesës së parë dhe të pjesës së dytë të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit

pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG”, si dhe të neneve 5/1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit të përhershëm të kalimit, për interes publik, mbi disa pasuri të paluajtshme, pronë private, që preken nga korridori i punës (rrugët hyrëse) dhe sistemi i gazsjellësit (mikrotuneli) në zonat Korçë, Devoll, Berat, Skrapar dhe Fier, pjesë e projektit të gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP).

2. Shpronësimi, marrja në përdorim të përkohshëm dhe vendosja e servitutit të përhershëm të kalimit mbi këto pasuri të bëhen në favor të shtetit, përfaqësuar nga ish-Ministria e Energjisë dhe Industrisë, aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, të paraqitur në tabelën bashkëlidhur, për sipërfaqen prej 29 (njëzet e nëntë) m² që shpronësohet; për sipërfaqen prej 7 433 (shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e tre) m² që merret në përdorim të përkohshëm; për sipërfaqen prej 1 511 (një mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) m² mbi të cilën vendoset servituti, me një vlerë të përgjithshme prej 29 102 690.65 (njëzet e nëntë milionë e njëqind e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Marrja në përdorim të përkohshëm për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të jetë përkatësisht sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi:

a) 1-vjeçar (njëvjeçar), për pasuritë që preken nga “Korridori i punës për 1 vit”;

b) 2-vjeçar (dyvjeçar), për pasuritë që preken nga “Sistemi i gazsjellësit (Mikrotuneli)”.

5. Vlera e përgjithshme prej 29 102 690.65 (njëzet e nëntë milionë e njëqind e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e pesë) lekësh dhe të gjitha shpenzimet e tjera procedurale të përballohen nga shoqëria TAP AG, si subjekti kërkues i kësaj kërkese.



6. Për likuidimin, për efekt të shpronësimit, marrjes në përdorim të përkohshëm dhe vendosjes së servitutit mbi pasuritë e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur të procedohet si më poshtë vijon:

a) Për të gjitha pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, pronarët të likuidohen, për efekt të shpronësimit, marrjes në përdorim të përkohshëm dhe vendosjes së servitutit, pas dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë, që do të lëshohet nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pranë shoqërisë TAP AG.

b) Për të gjitha pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “ZVRPP-ja konfirmon se mbi pasurinë është vendosur kufizim”, pronarët të likuidohen, për efekt të shpronësimit, marrjes në përdorim të përkohshëm dhe vendosjes së servitutit, pas heqjes së kufizimit dhe dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë, pranë shoqërisë TAP AG.

c) Për të gjitha pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “ZVRPP-ja konfirmon se mbi këtë pasuri është vendosur sekuestroja”, pronarët të likuidohen, për efekt të shpronësimit, marrjes në përdorim të përkohshëm dhe vendosjes së servitutit, pas heqjes së masës së sekuestros dhe dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë, pranë shoqërisë TAP AG.

7. Çdo pronar, për t’u likuiduar për efekt të shpronësimit, marrjes në përdorim të përkohshëm dhe vendosjes së servitutit, të dorëzojë pranë shoqërisë TAP AG, dega Shqipëri, dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.

8. Çdo përdorues të likuidohet, për efekt të kompensimit të kulturave për shumat përkatëse, të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në bazë të kopjes së dokumentit të identifikimit, vërtetimit bankar lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe certifikatës familjare që do të dorëzojë pranë shoqërisë TAP AG.

9. Shoqëria TAP AG të kryejë likuidimet përkatëse në zbatim, në bazë të pikave 6, 7 dhe 8, të këtij vendimi.

10. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatësisht, në Korçë, Devoll, Berat, Skrapar dhe Fier, të pezullojnë të gjitha transaksionet për pasuritë sipas listave që i bashkëlidhen këtij vendimi, deri në momentin kur do të realizohet regjistrimi i pasurive që shpronësohen, merren në përdorim të përkohshëm dhe mbi të cilat vendoset servituti i kalimit në favor të shtetit.

11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatësisht, në Korçë, Devoll, Berat, Skrapar dhe Fier, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë që do t’u vihet në dispozicion nga shoqëria TAP AG.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria TAP AG, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatësisht, në Korçë, Devoll, Berat, Skrapar dhe Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



RRETHET: KORÇË , DEVOLL, BERAT DHE SKRAPAR

Nr	Pronari/Përdoruesi			Z. K.	Nr. pas	Lloji pas.	Sip. m ² Përdorim të përkohshëm 2 vjet	Çmimi i / m ²	Vlera lekë	Sip. m ² Servitut	Çmimi/ m ²	Vlera lekë	Sip.m ² Shpronësim	Çmimi/m ²	Vlera lekë	Vlera totale e kulturave	Objekte Vlera lekë	Vlera totale Lekë	Indeksi i hartës	Shënime
LISTA E PASURIVE TË CILAT PREKEN NGA SISTEMI I GAZSJELLËSIT (MIKROTUNELI)																				
1	Petrit	Reshat	Xhizdari	2739	207	Kullotë				410.00	101	41,271.42				17,425.00		58,696.42	K-34-125-(135-B)	ZVRPP konfirmim se pasuria ka kufizim
	Muharrem	Reshat	Xhizdari																	
	Beqir	Reshat	Xhizdari																	
	Ferdinant	Reshat	Xhizdari																	
	Lavdiqe	Reshat	Xhizdari																	
	Drita	Reshat	Xhizdari																	
	Tomorr	Hajri	Shurdhi																	
Leonora	Hajri	Muabelliu																		
Albana	Hajri	Shurdhi																		
2	Pellumb	Sheme	Sulka	2739	130/3	Arë	223.00	69.8	15,554.25	44.00	140	6,138.00				540,747.27		562,439.52	K-34-125-(119-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Baki	Ferit	Caushi	2739	196/3	Truall	31.00	109.8	3,402.25							372.00		3,774.25	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmim se mbi pasurinë është vendosur sekuestro konservative
4	Daut	Iljaz	Ymeri	2739	130/31	Arë	39.00	69.8	2,720.25							48,590.50		51,310.75	K-34-125-(119-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Maria	Rushan	Sulka	2739	130/5	Arë				66.00	140	9,207.00				164,230.40		164,230.40	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmim se pasuria ka kufizim
	Faik		Sulka																	
6	Maria	Rushan	Sulka	2739	130/6	Arë				47.00	140	6,556.50				16,461.00		16,461.00	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmim se pasuria ka kufizim
	Feti		Sulka																	
7	Maria	Rushan	Sulka	2739	130/7	Arë				69.8	27,900.00					27,900.00		27,900.00	K-34-125-(119-C)	ZVRPP konfirmim se pasuria ka kufizim
	Feti		Sulka																	
8	Krenar	Hetem	Sulka	2739	130/2	Arë	38.00	69.8	2,650.50							43,294.26		45,944.76	K-34-125-(119-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Pellumb	Sheme	Sulka	2739	130/4	Arë	355.00	69.8	24,761.25	310.00	140	43,245.00						68,006.25	K-34-125-(119-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Maria	Rushan	Sulka	2739	130/9	Arë										128,727.00		128,727.00	K-34-125-(119-C)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	Feti		Sulka																	
11	Dajlan	Rahman	Scitaj	1420	1/19	Truall	775.00	175.0	135,625.00	344.00	630	216,720.00				9,300.00	16,208,116.64	16,569,761.64	CO-II-2	ZVRPP konfirmim se mbi pasurinë është vendosur sekuestro konservative dhe kufizim
	Ardian	Shaqir	Caka																	
12	Ferdinand	Servet	Cerri	1420	1/4 N1	Njesi	57.00	175.0	9,975.00							684.00	895,848.20	906,507.20	CO-II-1	ZVRPP konfirmim se mbi pasurinë është vendosur sekuestro konservative dhe kufizim
13	Flamur	Novrus	Xhaferllari	1420	1/4 N2	Njesi	563.00	175.0	98,525.00	223.00	630	140,490.00				6,756.00	8,851,253.80	9,097,024.80	CO-II-1	ZVRPP konfirmim se pasuria ka kufizim
14	Flamur	Nevus	Xhaferllari	1420	1/70	Arë	53.00	69.8	3,696.75	6.00	140	837.00				10,136.00		14,669.75	CO-II-1	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Sazan	Jakup	Satka	1420	1/21	Njesi	251.00	175.0	43,925.00							3,012.00		56,000.00	CO-II-2	ZVRPP konfirmim se pasuria ka kufizim
	Fejzo	Jakup	Satka																	
	Xhevit	Sokol	Hyseni																	
	Shoqeria "ALB KALUSTYAN" shpk																			
16	Kastriot	Xhevit	Selimi	1420	1/67	Truall	450.00	175.0	78,750.00	61.00	630	38,430.00				5,400.00		122,580.00	CO-II-2	ZVRPP konfirmim se mbi pasurinë është vendosur sekuestro konservative
17	Flamur	Novrus	Xhaferllari	1420	1/5	Truall	208.00	175.0	36,400.00							2,496.00		38,896.00	CO-II-4	ZVRPP konfirmim se pasuria ka kufizim
LISTA E PASURISË E CILA PREKET NGA RRUGËT HYRËSE																				
18	Robert	Ilo	Kurtiqi	3790	849/6	Arë							29.00	505	14,645.00			14,645.00	K-34-126-(116-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
LISTA E PASURIVE TË CILAT PREKEN NGA KORRIDORI I PUNËS							Sip. m ² Përdorim të përkohshëm 1 vit													
19	Arben	Ali	Beqe	366	64/2	Arë	15.00	97.3	1,458.75									56,000.00	K-34-126-(40-B)	Konfirmuar nga ZVRPP



20	Ilirian		Skenderas	0											165.00		165.00		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
21	Idaet	Shaban	Hasankolli	163 1	17	Arë	193.00	63.1	12,183.13						1,061.50		13,244.63	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
22	Sali	Hysen	Elezi	163 1	12/1	Arë	530.00	63.1	33,456.25								33,456.25	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
23	Vangjel	Hasan	Ramolli	163 1	80/8	Arë	214.00	80.8	17,280.50								56,000.00	K-34-126-(119-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
24	Jorgo	Neki	Ramolli	163 1	80/6	Arë	249.00	63.1	15,718.13								15,718.13	K-34-126-(119-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
25	Pilo	Nikolla	Zguri	366 8	281/48	Arë	163.00	80.8	13,162.25						978.00		56,000.00	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
26	Dhimiter		Binjaku	366 8	281/45	Arë	23.00	41.3	948.75						138.00		56,000.00	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
27	Pandi		Binjaku	366 8	281/46	Arë	89.00	41.3	3,671.25						534.00		56,000.00	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
28	Leksa		Zguri	366 8	281/47	Arë	144.00	63.1	9,090.00						864.00		56,000.00	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
29	Theodhor	Ramada n	Banushi	135 5	31/11	Arë	386.00	97.3	37,538.50								37,538.50	K-34-114-(238-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
30	Rami		Banushi			Arë									6,257.06		6,257.06		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
31	Gazmon		Bajraktari	135 5	119/1	Arë									5,490.00		5,490.00	K-34-114-(237-B)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
32	Flamur	Riza	Hatija																
33	Xhezmiqe	Rapi	Hatija																
34	Lorenc	Flamur	Hatija																
35	Vangjel	Flamur	Papa	317 3	42/9	Arë	337	103.5	34,879.50						2,022.00		36,901.50	K-34-112-(167-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
36	Resmi	Flamur	Hatija																
37	Flutur	Riza	Xhamaj																
38	Fetije	Riza	Kulli																
39	Kalem		Plashniku	850 3	24/27	Ullishte	348.00	81.1	28,231.50						6,488.00		34,719.50	BRJ-9	Konfirmuar nga ZVRPP
40	Perpanim	Alush	Bodulli	375 4	28/7	Arë	254.00	103.5	26,289.00								26,289.00	K-34-125-(18-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
41	Refit	Nazif	Hysi	263 2	40/5	Arë	203.00	81.1	16,468.38						3,146.50		19,614.88	K-34-125-(18-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
42	Veli	Selman	Alibeja	288 1	523/13	Arë	385.00	103.5	39,847.50						6,337.10		46,184.60	K-34-112-(188-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
43	Jorgo	Stefan	Priftuli	390 3	75/3/21	Arë									2,608.32		2,608.32	K-34-114-(236-A)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
44	Lytife		Mullali	390 3	31/111	Arë									126.00		126.00	K-34-114-(236-A)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
45	Erion	Teki	Pillati	140 3	137/38	Arë									1,419.00		1,419.00	K-34-126-(25-B)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
46	Durim		Beqiri	198 4	227/18	Arë									1,316.80		1,316.80	K-34-112-(166-B)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
47	Astrit		Laska																Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
48	Pelivan		Lirjani	330 1	32	Arë									174.00		174.00		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
49	Pellumb		Nepajaj																Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
50	Donika		Xhela	319 6	64/5	Arë									8,825.70		8,825.70		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
LISTA E PËRDORUESVE MBI PASURINË SHITET																			
51	Shtet			142 0	17/9	Arë									136,222.28		136,222.28	CO-1-3	Avni Myzyri është përdoruesi i cili likuidohet vetëm për vlerën e kulturës
TOTALI							7,433.00		805,984.38	1,511.00		502,894.92	29.00		14,645.00	1,527,010.21	25,955,218.64	29,102,690.65	

**VENDIM**

Nr. 528, datë 27.9.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 37, DATË 18.1.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 100/20 KV GJIRI I LALËZIT, DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 37, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Tabela e përmendur në pikën 1 zëvendësohet me tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, me këtë përmbajtje:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë totale të shpronësimit prej 1 152 530.7 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë pikë shtatë) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 1 152 530.7 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë pikë shtatë) lekësh, dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga fondet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE, sh.a.), si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.”.

3. Pika 5 ndryshon, me këtë përmbajtje:

“5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit tetor 2017.”.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Lista e pronarëve që shpronësohen për interes publik, për ndërtimin e nënstacionit 110/20 kV Gjiri i Lalëzit, Durrës, Fshati Kuraten, Njësia Administrative Ishëm

Nr.	Pronari	Z.K.	Nr. i pasurisë	Lloji	Sipërfaqja m ²	Çmim lekë/m ²	Vlera lekë	Shënime
1	Thoma Çuni	2332	242/2	Arë	2903.1	397	1 152 530.7	Konfirmim nga ZVRPP
2	Shtet	2332	242/1	Kullotë	231.6			Konfirmim nga ZVRPP

UDHËZIM

Nr. 20, datë 22.9.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 52, DATË 3.12.2015, “PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4, të

nenit 76 dhe pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Tabela nr. 1/1 e udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën nr. 1/2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.



2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

Tabela 1/2

Në mbështetje të kuadrit të referencave për gjuhët, të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit njih testet e gjuhëve të huaja dhe nivelet si më poshtë:

Niveli	B1	B2	C1
<i>Gjuha angleze</i>			
Cambridge	PET	FCE	CAE
IELTS	4.0 / 5.0	5.5 / 6.0	6.5 / 7.0
TOEFL Internet-based Test (iBT)	57/86	87/109	110/120
TOEFL Paper-based Test (ITP)	460	543	627
TOEIC	381 / 649	650 / 785	786 / 935
GESE	-	7, 8, 9	10, 11
APTIS	Aptis B1	Aptis B2	Aptis C
<i>Gjuha gjermane</i>			
Goethe-Institut, Goethe Zentrum	Goethe-Zertifikat B1	Goethe-Zertifikat B2	Goethe-Zertifikat C1
TestDaF	-	TDN 3 - TDN4	TDN 5
OSD	OSD-Zertifikat B1	OSD-Zertifikat B2	OSD-Zertifikat C1
<i>Gjuha franceze</i>			
TFI	345/604	605/824	825
DELFB	DELF B1	DELF B2	DALFC1
TCF	TCF 300 - 399	TCF 400 - 499	TCF 500 - 599
TEF	TEF 361-540	TEF 541-698	TEF 699-833
<i>Gjuha italiane</i>			
Peruggia	CELI2 livello2	CELI3 livello3	CELI4 livello4
Sienna	CILS uno B1	CILS 2	CILS 3
PLIDA	PLIDA certification B1	PLIDA certification B2	PLIDA certification C1
<i>Gjuha spanjolle</i>			
DELE	DELE inicial	DELE intermedio	DELE superior

**NJOFTIM****Nr. 13541, datë 29.9.2017****MBI HYRJEN NË FUQI TË DISA
MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE**

1. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2011 për projektin “Programi i infrastrukturës komunale III”, nënshkruar më 18.4.2017, hyrë në fuqi më 7.6.2017.

2. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2011 për projektin “Programi i infrastrukturës komunale IV”, nënshkruar më 18.4.2017, hyrë në fuqi më 7.6.2017.

3. Marrëveshje për themelimin e fondit të Ballkanit Perëndimor dhe statuti i saj, bërë në Pragë, më 13.11.2015, hyrë në fuqi më 25.5.2017.

4. Marrëveshje për akordimin e grandit ekonomiko-teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, nënshkruar në Tiranë, më 6.6.2016, hyrë në fuqi më 8.5.2017.

5. Marrëveshje për ngritjen e Qendrës së Ekselencës në Financë (CEF), aderuar më 30.5.2016, hyrë në fuqi 4.7.2016.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Gazmend Barbullushi**

KËRKESE

Shtetasja Xhevaire Backa, e bija e Neimit, e datëlindjes 25.10.1948, lindur në Koshnicë dhe banuese në Sul Devoll, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë shpalljen të zhdukur të djalit të saj, Aleksander Backa, i datëlindjes 14.4.1998, si dhe caktimin e saj si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

**KËRKUESE
Xhevaire Backa**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë